




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



“ISP BROADCAST” SH.P.K.  
Numri i biznesit – 810011643  
Pronar – Qëndrim KRYEZIU  
OSHMA “ARB Aksion”  
Rr/24 Maji, nr. 46-1  
Prishtinë



**VENDIM**

për licencimin e Ofruesit të Shërbimeve Mediale Adiovizuale “ARB Aksion” për transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes – me seli në Prishtinë

**Faktet**

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audiovizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Rregullorja për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2021/01 e plotësuar dhe ndryshuar, ka hyrë në fuqi më 17 dhjetor 2021, përmes së cilës KPM ka krijuar bazën ligjore për licencimin e Ofruesve të Shërbimeve Audio dhe Audiovizuale të cilët transmetojnë përmes operatorëve të shpërndarjes, e që do të kenë mundësi të prodhojnë programe përmbajtjesore dhe t'i transmetojnë ato përmes cilit do operator të shpërndarjes.
3. Më datën 09 shkurt 2023, kandidati “ARB Aksion”, ka parashtruar aplikacionin për licencë të KPM-së për të vepruar si ofrues të shërbimeve mediale audiovizuale (OSHMA) për transmetim përmes operatorit të shpërndarjes.
4. Për shkak të mungesës së kuorumit për vendimmarrje të Komisionit të Pavarur të Mediave, nga data 15 tetor 2022 deri më datën 6 qershor 2023, kërkesa e kandidatit “ARB Aksion”, nuk ka arritur të shqyrtohet me kohë.



## Arsyetim

5. Komisioni vlerëson se, kandidati për licencë të KPM-së OSHMA “ARB Aksion”, në aplikacionin e tij ka paraqitur të dhënat e nevojshme për Licencë të KPM-së dhe në pajtueshmëri me Rregulloren KPM-2021/01.
6. Biznesi ISP Broadcast sh.p.k si kandidat për licencë të OSHMA “ARB Aksion”, posedon licencë të KPM-së për operator të shpërndarjes.
7. Komisioni vlerëson se, kandidati për licencë të KPM-së “ARB Aksion” ka ofruar të dhënat e mjaftueshme për vlerësim të aplikacionit. Materialet e ofruara si pjesë e aplikacionit konsiderohen të qëndrueshme, përfshirë skemën programore, të dhënat rreth aftësive profesionale dhe menaxheriale për të udhëhequr me ofrues të shërbimeve mediale audiovizuale, si dhe të dhënat rreth qëndrueshmërisë financiare.
8. Komisioni konstaton se biznesi ISP Broadcast SH.P.K, ka shlyer obligimet financiare ndaj KPM-së.
9. Sipas Nenit 15, paragrafit 5 të Rregullores KPM-2021/01, kandidati për licencë të KPM-së “ARB Aksion”, duhet të veprojë në pajtueshmëri me të gjitha rregullat dhe aktet tjera nënligjore të nxjerra nga KPM, në pajtueshmëri me Ligjin e KPM-së, si dhe me ligjet tjera të zbatueshme në Republikën e Kosovës.
10. Komisioni vlerëson se, kandidati “ARB Aksion” ka përmbushur kriteret kualifikuese për t’u pajisur me licencë të KPM-së për ofrues të shërbimeve mediale audiovizuale, në pajtim të plotë me Rregulloren KPM-2021/01.

## Vendim

11. Komisioni në takimin e datës 17 korrik 2023, vendos që kandidatit “ARB Aksion”, me seli në Prishtinë, t’i lëshoj licencën për të vepruar si Ofrues i Shërbimeve Mediale Audiovizuale me transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes, në Republikën e Kosovës.
12. Këtë vendim e lëshon Komisioni dhe i njëjti hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.



Jeton Mehmeti

Kryetar

Komisioni i Pavarur i Mediave



17.07.2023

datë